## METODAT E HULUMTIMIT DHE ANALIZA

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Departamenti I Shkencave Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci** |
| **Titulli i lëndës:** | **Metodat e Hulumtimit dhe Analiza** |
| **Niveli:** | **Master** |
| **Statusi lëndës:** | **Obligative** |
| **Viti i studimeve:** | **I-rë, semestri i I-rë** |
| **Numri i orëve në javë:** | **3+0** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **7** |
| **Koha / lokacioni:** | |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | **Prof. Dr. Sejdi Rexhepi** |
| **Detajet kontaktuese:** | **sejdi.rexhepi@uni-pr.edu** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Kjo lëndë ofron njohuri për metodat e hulumtimit dhe analizës përmes shpjegimit teorik të vetë kuptimit të kërkimeve dhe të analizës, duke mbuluar të gjitha fazat, teknikat dhe instrumentet kryesore të procesit të hulumtimit, analizës dhe të nxjerrjes së përfundimeve. Lënda shpjegon rregullat, metoda e modele të kërkimeve, hulumtimit, analizës, nxjerrjes dhe të shkruarit e përfundimeve profesionale e shkencore. |
| **Qëllimet e lëndës:** | • **Ofrimi i njohurive të avancuara** lidhur me metodat, modelet dhe strategjitë e hulumtimit dhe analizës profesionale dhe shkencore;<br>• **Zhvillimi i aftësive** për të **njohur dhe kuptuar** metodat dhe instrumentet kryesore të hulumtimit dhe të analizës;<br>• Zhvillimi i **aftësive për aplikimin praktikë dhe të pavarur** të njohurive në hulumtime, kërkime dhe analiza profesionale dhe shkencore;<br>• Zhvillimi i aftësive **për të nxjerrë përfundime** profesionale e shkencore dhe për ti shkruar ato. |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të ligjëratave (kursit)) studentet do të jenë në gjendje:<br>• Ti **njohin** dhe ti **dinë** metodat, modelet, dhe strategjitë e hulumtimit dhe analizës profesionale dhe shkencore;<br>• Të dinë të **argumentojnë** kërkimin përmes përcaktimit të qartë të qëllimit të hulumtimit, përkufizimit të koncepteve kryesore të hulumtimit, pyetjes hulumtuese dhe parashtrimit të hipotezave;<br>• Të dinë **të përdorin** njohurit e fituara për kërkim të pavarur profesional e shkencor;<br>• **Të dinë ti shqyrtojnë, përpunojnë dhe analizojnë** të dhënat e grumbulluara;<br>• Të dinë **ti analizojnë dhe ti argumentojnë** rezultatet e fituara;<br>• Të dinë **të nxjerrin përfundime** të bazuara profesionale e shkencore si dhe ti shkruajnë ato sipas metodologjisë shkencore. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 2 | 13 | 26 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 5 | 5 |
| Punë praktike | 1 | 15 | 15 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume, seminare | 2 | 15 | 30 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 5 | 5 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 3 | 15 | 45 |
| Përgatitja përfundimtare për | 1 | 15 | 15 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| provim | | | |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 1 | 5 | 5 |
| Projektet, prezantimet ,etj. | 1 | 10 | 10 |
| **Totali** | | | 175 |
| | | | |
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | ***a).Qasja është e bazuar në pjesëmarrjen aktive të studentëve***<br><br>1. Mësimdhënësi shpjegon objektivat e mësimit studentëve përmes ligjëratave,<br>2. Përmes tabelës, projektorit dhe formave tjera vizuale prezantohen teoritë dhe konceptet kryesore<br>3. Mësimi i kombinuar interaktiv do të përdoret<br>4. Konkludime të përbashkëta do të nxirren përmes diskutimit të pyetjeve dhe çështjeve të ngritura.<br><br>**b). Aktivitetet Grupore**<br>1. Tryeza pune, diskutime grupore, prezantime grupore<br><br>**c). Aktivitetet tjera**<br>1. Kërkime të pavarura nga studentët<br>2. Prezantimi i rezultateve<br>3. Seminare<br><br>**d). Mjetet e punës:**<br>Tekste mësimore, artikuj, harta, tabela, projektori, fletat e punës, materiale të përgatitura nga mësimdhënësi, etj. | | |
| | | | |
| **Metodat e vlerësimit:** | Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë të disa kritereve bazë. Studentët do të kenë dy teste provuese me shkrim gjatë mbajtjes së ligjëratave dhe një test (provimin) përfundimtar.<br>Vlerësimi dhe notimi do të bëhet duke marr parasysh suksesin e treguar në teste dhe provimin | | |

| | |
|---|---|
| | final si dhe angazhimin e përgjithshëm.<br>Çdo student ka për obligim që  të përgatisë dy detyra të shtëpisë si dhe një punim seminarik të cilat së bashku janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm nga kjo lëndë. Tema e detyrave të shtëpisë si dhe e seminarit duhet të caktohet në bashkëpunim me mësimdhënësin e në pajtim me planin mësimorë nga lënda.<br><br>Nota do të ndërtohet duke marrë për bazë këto kritere:<br>Detyra e parë & aktiviteti: 10%<br>Detyra e dytë & aktiviteti: 10%<br>Punimi Seminarik 20%<br>Provimi final 50%<br>**Total** **100%** |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | **a) Ligjëratat e mësimdhënësit**<br><br>b) **Literatura në gjuhen angleze**<br>1. Research Methods for Political Science: Quantitative, Qualitative and Mixed Method Approaches 3rd Edition, David E. McNabb, Routledge, 2021.<br>2. Political Science Research Methods 9th Edition, Janet B. Johnson, H. T. Reynolds, Jason D. Mycoff, SAGE, 2020.<br>3. Research Methods: A Practical Guide for the Social Sciences, by Bob Matthews and Liz Ross, Person Education Limited, 2010<br>4. Social Scientific Research, by Dawn Brancati, SAGE Publications Ltd., London, 2018.<br>5. Political Science Research Methods, Eight Edition, by Janet Buttolph Johnson, H. T. Reynolds, SAGE Publication, USA, 2016.<br><br>**c). Literatura në gjuhen shqipe:**<br>1. Metodat e Hulumtimit, Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane, by Bob Matthews and Liz Ross, Person Education Limited, 2010, Përkthim nga Qendra për Arsim demokratik (CDE), Tiranë.<br>2. Research methodology, Ranjit Kumar, Përkthyer në gjuhen shqipe nga Center for International Education, Development, and Research, 2014. |

| | |
|---|---|
| | 3. Hyrje në Metodat Hulumtuese në Shkencat Shoqërore, Miroslav Vujovic, Përkthim nga kroatishtja, Universiteti "Victory", Prishtinë, 2009.<br>4. Shkrimi Akademik, Hyrje në shkrimin akademik, Holger Kachelein, Përkthim, ablPAPER, Tiranë, 2011. |
| **Literatura shtesë:** | **b). Në gjuhen Angleze**<br>1. Research Methods in Political Science: An Introduction Using Micro Case ExplorIt 7th Edition, by Michael K. Le Roy, Michael Corbett, Thomson & Wadsworth, 2009, Boston USA.<br>2. Perspectives in Social Research Methods and Analysis: A Reader for Sociology 1st Edition by Howard Lune (Editor), Enrique S. Pumar (Editor), Ross J. Koppel (Editor), 2010, SAGE Publications,<br>3. Research Methods, A Practical Guide for Students and Researchers, Willie Tan, *NUS, Singapore, 2017.* |

**Plani i dizajnuar i mësimit:**

| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
|---|---|
| ***Java e parë:*** | Prezantime hyrëse, prezantimi i mësimdhënësit, prezantimet hyrëse për lëndën dhe kurrikulën, metodologjia e vlerësimit dhe notimi. Prezantimi koncepteve kyçe të lëndës Metodologjia e hulumtimit dhe analiza. |
| ***Java e dytë:*** | **Çfarë është një hulumtim**? Hulumtimi në Shkencat Sociale; Metoda shkencore; Shkeljet gjatë përdorimit të metodave; Sa "Shkencore" janë Shkenca Sociale? |
| ***Java e tretë*:** | **Etika e Kërkimit**; Çfarë hulumtimi është i lejueshëm? Vjedhjet intelektuale; Mashtrimi i Kërkimeve; Rishikimi nga ana e kolegëve të fushës; Transparenca e Kërkimit |
| ***Java e katërt:*** | **Identifikimi i pyetje kërkimore**; Çfarë përbën një temë të mirë kërkimore? Nga tema në pyetje në kërkim; Bërja e një kontributi; Gjetja e frymëzimit. |
| ***Java e pestë:*** | Kryerja e **Rishikimit të Literaturës**; Identifikimi i Literaturës; Përcaktimi i literaturës; Strukturimi i literaturës, Shqyrtimi i literaturës; Si ta diskutojmë letërsinë? |
| ***Java e gjashtë*:** | **Argumentimi i arsyes për hulumtim;** Ndërtimi i koncepteve efektive; Pse Konceptet janë me rendësi; Karakteristikat e koncepteve të mira; Ndërtimi i koncepteve efektive; Shtrirja e konceptit. |

| | |
|---|---|
| ***Java e shtatë:*** | **Bërja e argumenteve të forta**; Qasja deduktive dhe induktive; Llojet e rrethanave; Udhëzuesit e ndërveprimit; Efektet e ndërveprimit; Shkaktaret e Dyfishtë (kuazaliteti I dyfisht); Problemi në argumentet shkakësore (kauzale). |
| ***Java e tetë:*** | **Metoda dhe përzgjedhja e rasteve**; Përzgjedhja e metodës; Cila Qasje Metodologjike është më e mira? Rëndësia e Përzgjedhjes së Metodës; Cilën Qasje Metodologjike do të Zgjidhni? |
| ***Java e nëntë:*** | **Metodat e përziera të hulumtimit**; projektimi, Interpretimi, Përzgjedhja e rasteve; Sa raste duhet studiuar; Plotësimi i rasteve, përzgjedhja e mostrës. |
| ***Java e dhjetë:*** | **Metodat cilësore dhe analizat**; Intervistat, Të intervistuarit; Llojet; Si të përdorni intervista; Procesi i Intervistimit; Udhëzues për intervista; Analizimi i të dhënave të Intervistës.<br>Grupet e fokusit; Si të përdorim grupet e fokusit; Kur përdoret grupet e fokusit; Kryerja e grupeve të fokusit; Analiza e të dhënave të grupit të fokusit. |
| ***Java e njëmbëdhjetë*:** | **Vëzhgimi i pjesëmarrësve**; Karakteristikat e Vëzhgimeve të Pjesëmarrësve; Llojet e Vëzhgimit të Pjesëmarrësve; Shfrytëzimi i Vëzhgimit të Pjesëmarrësve; Kryerja e Vëzhgimit të Pjesëmarrësve; Analiza e të Dhënave të Vëzhgimit të Pjesëmarrësve.<br>Gjurmimi i procesit; Teknikat e gjurmimit të Procesit; Standardet për Vlerësimin e Provave; Gjurmimi i procesit në praktikë; Kufizimet e gjurmimit të procesit.<br>Metoda krahasuese e rastit; Metoda e ndryshimit; Dizejnime të rastësishme të rasteve; Analiza krahasuese cilësore (QCA). |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | Metodat dhe analizat sasiore; Matja; Lloji i masave; Cilësia e matjes.<br>Të dhëna sasiore; Llojet e të dhënave dhe burimet; Standardet e cilësisë së të dhënave; Teknikat e vlerësimit të cilësisë së të dhënave; Shpërndarjet e të dhënave.<br>Analiza e përmbajtjes; Materialet burimore; Masat dhe aplikimet; Teknikat dhe mjetet; Teknika të ndryshme si të...! |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | Sondazhet; Llojet e sondazheve; Përdorimi i sondazheve; Hartimi i pyetësorit të vrojtimit; Administrimi i sondazhit; Analiza e rezultateve të anketimit.<br>Eksperimentet; Llojet e eksperimenteve; Vlerësimi i cilësisë së eksperimentit; Analiza e rezultateve të eksperimenteve. |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | Studimet observuese; Pikat e forta të studimeve observuese; Nxjerrja e përfundimit shkakësor; |

| | |
|---|---|
| | Eksperimentet Natyrore; Teknikat e vlerësimit përfundimeve të nxjerra shkakësore. |
| ***Java e pesëmbëdhjetë***: | Përfundimet, Shkruaja e punimit në shkencat sociale, Paraqitja e të dhënave, Çështjet në fillim, Trupi i punimit (mesi), Çështjet në fund (mbyllja). |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| Studentët me qëllim të arritjes së suksesit të lartë në studime duhet që:<br>1. Të vijojnë rregullisht ligjëratat dhe ushtrimet e parapara.<br>2. Të marrin pjesë në mënyrë aktive në ligjërata përmes pyetjeve, debateve dhe formave tjera të veprimit interaktiv.<br>3. Në marrëveshje me mësimdhënësin të punojnë dhe të prezantojnë publikisht një punim seminarik prej 12-15 faqe.<br>4. Në marrëveshje me mësimdhënësin të punojnë dy detyra të shtëpisë prej 1.5-2.5 faqe.<br>5. Të marrin pjesë në prezantimin e një detyre të shtëpisë lidhur me njësitë mësimore.<br>6. Gjatë kohës së mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, testeve apo provimeve kanë për obligim që t'i nënshtrohen kodit të mirësjelljes (mbajtja e qetësisë në mësim, hyrja me kohë në sallë, lëshimi i sallës me pëlqimin e mësimdhënësit, etj.). |